



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafi 1, pika 1.3 e Statutit të Komunës së Gjilanit, (01.Nr.016-126211 të dt.06.11.2014), në zbatim të nenit 7, paragrafi 1, 2 dhe 3, nenit 10, paragrafi 1, pika 1.5 e Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, me Rekomandim të Komitetit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe pas Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me date 16.08.2017, miraton :

V E N D I M

Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim për periudhë afatshkurtër (15 vite), për ndërtimin dhe vendosjen e Trafostacioneve 10(20)/0.4 kV.

1. Kuvendi i Komunës së Gjilanit **Aprovon Propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën afatshkurtër 15 vite, pa pagesë, pjesët e ngastrave kadastrale :**

- Njësia kadastrale P-70403026-01221-1, lloji i njësisë : parcelë; lloji i pronës: pronë shoqërore; zona : rurale; sipërfaqja e parcelës :1236687 m²; vendi i quajtur: “Gaber”; lloji i shfrytëzimit të parcelës : bujqësore; shfrytëzimi aktual i parcelës: kullosë; klasa e kualitetit të parcelës : kullosë e klasit 5; Zona Kadastrale Zhegër; pronari: P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjilan. **Sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e trafostacionit dhe e cila ipet në shfrytëzim në këtë ngastër kadastrale është : 9m².**
- Njësia kadastrale P-70403026-05388-0, lloji i njësisë : parcelë; lloji i pronës: pronë shoqërore; zona : rurale; sipërfaqja e parcelës :1138 m²; vendi i quajtur: “Gudiq”; lloji i shfrytëzimit të parcelës –rajon ujqor; Zona Kadastrale Zhegër; pronari: P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjilan. **Sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e trafostacionit dhe e cila ipet në shfrytëzim në këtë ngastër kadastrale është : 9m².**
- Njësia kadastrale P-70403033-02421-0, lloji i njësisë : parcelë; lloji i pronës: pronë shoqërore; zona : rurale; sipërfaqja e parcelës :7642 m²; vendi i quajtur: “Osoje”; lloji i shfrytëzimit të parcelës –ifrastrukturë rrugë e pakategorizuar; Zona Kadastrale Kmetovc; pronari: P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjilan. **Sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e trafostacionit dhe e cila ipet në shfrytëzim në këtë ngastër kadastrale është : 9m².**

2. Pronat e përshkruara në pikën (1) të Vendimit, respektivisht sipërfaqet e nevojshme për vendosjen e trafostacioneve i ipen në shfrytëzim pa pagesë, për periudhën prej 15 viteve, **Kompanisë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), Divizionit të Rrjetit- Distriktit në Gjiilan**, me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë për furnizimin e qytetarëve me energji elektrike dhe përmisimin e tensionit të rrymës elektrike sipas standardeve të parapara teknike.

3. Shfrytëzuesi, **Kompania Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), Divizioni i Rrjetit- Distriktit në Gjiilan**, obligohet që pas plotëfuqishmërisë së këtij vendimi dhe para vendosjes së trafostacioneve në parcelat e dedikuara për këtë qëllim, të pajiset me pëlqimin dhe lejen urbanistike në mënyrë që vendosja e tyre mos të bie ndesh me Planet Urbanistike dhe Planet Zhvillimore të Komunës.

4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ta bënë parcelimin e sipërfaqeve të cilat ipen në shfrytëzim dhe të njejtat t'i regjistrojnë në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim për periudhën për 15 vite, Kompanisë KEDS.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Nr.01016-84829

Gjilan, më 16.08.2017

Kryesuesja e KK-Gjilan

/Shpresa KURTESHI/